

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 55 paragrafi (2) nënparagrafët 2, 3 dhe 4 nga Ligji i njëjtë dhe pikat 25 dhe 26 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve (Tekst i pastruar) ark.nr.01-2970/1 datë 05.07.2024, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1372/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-1832/4 datë 24.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 18-të mbajtur më 24.04.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare radiodifuzive (SHTR) 24 VESTI SHPKNJP Shtip, për shkeljen e kryer të nenit 55 paragrafi (2), nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe pikat 25 dhe 26 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve, të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 mars 2025, në emisionin e specializuar informativ "Faktori shëndetësor me Biljana Debarlievën", nuk u respektuan kushtet për plasim të produkteve në programet audiovizuale, si dhe rregullat për shënimin e programeve që përmbajnë plasim të produkteve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1372/1 datë 27.03.2025, i cili është pjesë përbërëse i këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2.URDHËROHET që SHTR 24 Vesti SHPKNJP Shtip në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Udhëzimin për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve.

3.Pas përfundimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4.Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia), në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga

operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe aktet e miratura nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtim me këtë Ligj, në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Neni 55 paragrafi (2) nënparagrafët 2, 3 dhe 4 nga LSHMAAV përcakton që programet audio dhe audiovizuale që përmbajnë plasim të produkteve përveç kushteve të tjera, duhet të përmbushin dhe kushtet në vijim: nuk duhet të nxisin drejtpërdrejt blerjen ose marrjen me qira të mallrave ose shërbimeve, në veçanti përmes rekomandimeve të veçanta promovuese të mallrave dhe shërbimeve; nuk duhet t'i japin rëndësi të tepërt (theksim ose referencë) produktit në fjalë dhe shikuesit dhe dëgjuesit të informohen qartë rreth ekzistencës së plasimit të produktit në fillim dhe në fund të programit dhe gjatë vazhdimit të programit pas çdo pauze për reklamim, me qëllim që të shmanget konfuzioni midis shikuesve dhe dëgjuesve. Dispozitat nga paragrafi (2) nënparagrafi 4 të këtij neni nuk zbatohen nëse programi audio dhe audiovizual që përmban plasim të produkteve nuk është prodhuar ose porositur nga ofruesi i shërbimit mediatik ose nga ndërmarrje lidhur me ofruesin e shërbimit mediatik (paragrafi 3 i nenit 55 të LSHMAAV).

Në Udhëzimin për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve, në kapitullin me titull "Shënimi i produkteve të plasuara" në pikën 25, përcaktohet se për të shmangur konfuzionin midis shikuesve dhe dëgjuesve, programet dhe videot e krijuara nga përdorues që përmbajnë plasim të produkteve duhet të shënohen qartë në fillim dhe në fund të kohëzgjatjes së tyre, si dhe pas çdo pauze për reklamim. Pika 26 përcakton që programet audiovizuale dhe videot e krijuara nga përdoruesit që përmbajnë plasim të produkteve duhet të identifikohen duke shfaqur logon dhe tekstin në ekran, si më poshtë: logoja duhet të shfaqet dukshëm në çdo pjesë të ekranit në mënyrë që të jetë lehtësisht e dukshme për shikuesit, por nuk duhet të mbulojë pjesë thelbësore të veprimit; për shembull, personazhe ose titra, dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk duhet të cënojnë integritetin e programit ose videon e krijuar nga përdoruesi dhe nuk duhet të mbulojë logon e ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual, shenjën e kategorisë së programit, reklamën me ekran të ndarë dhe shenjat e tjera, që shikuesit duhet t'i ofrojnë informacion në lidhje me natyrën dhe/ose karakteristikat e programit/videos, dhe çdo shfaqje e logos duhet të shoqërohet me tekst dhe të zgjasë së paku 10 sekonda. Gjithashtu, në pikën 26 të Udhëzimit grafikisht është treguar pamja e logos dhe tekstit që duhet të dallohet në ekran.

Në kuadër të kompetencave të ligjore, Agjencia, përmes Sektorit për çështje programore, më 27 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) mbi shërbimin programor televiziv të SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip, të transmetuar më 4 mars 2025, në nivel shtetëror, dhe konstatoi shkelje të nenit 55 paragrafi (2) nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LSHMAAV dhe pikave 25 dhe 26 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve.

Shkelja është kryer në edicionin e emisionit të specializuar informativ "Faktori Shëndetësor me Biljana Debarlievën", që transmetohet në shërbimin programor televiziv SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip më 4 mars 2025, si më poshtë:

- në edicionin e emisionit me temë (të shkruar në telop) kishte: *"Trashësia, rrezik për një numër sëmundjesh si diabeti, sëmundjet e zemrës dhe lloje të caktuara të kancerit"*, dhe ishte realizua si intervistë me Dr. Valentina Krsteska, udhëheqëse e "Qendrës Lipo-Diet" nga Shkupi. Shpesh dhe gjatë, drejtpërdrejt, verbalisht dhe vizualisht, gjatë emisionit u promovuan posaçërisht përfitimet e mundshme të të ashtuquajturës metodë "liposuksion jo-invaziv", si dhe përdorimi i preparateve/suplementeve/dietës (liposuksion) Lipo- α dhe Lipo- β ;

- përveç sa më sipër, spikat dhe citimi i mëposhtëm (i përkthyer fjalë për fjalë, pa redaktim), me kohëzgjatje prej 09:28:58 orë deri në 09:33:58 orë. *"Është një program dietoterapie për zvogëlimin e kilogramëve të tepërt, për fillim, për 30 ditë. Është i ndarë në dy pjesë nga 15 ditë secila, ku në 15 ditët e para, këto janë 15 ditët më të rëndësishme, në program mirren produktet tona Lipo- α dhe Lipo- β . Lipo- α është një preparat i mirë që është si pluhur, është proteinë me hirrë nga qumështi, ka vitamina, B6, B12, zink dhe një suplement shumë i mirë, është konjac-glukomanan - këto janë fibra bimore, polisakaride, të cilat fryhen vetëm në kontakt me ujin. Kur ajo pije tretet, kur pihet, jep ngopje dhe mund të zgjasë 3 deri në 4 orë. Prandaj, gjatë ditës merret tre herë, në ato pije*

ka një shije të këndshme salepi, mund të shtohet kanellë, mund të shtohet stevia. Së bashku me ato pije merren kapsula, edhe aminoacide. Ato kapsula, me përbërjen e 4 aminoacideve të balancuara, thelbësore, janë të nevojshme për organizmin, veçanërisht për të ruajtur indet muskulore, në mënyrë që organizmi gjatë dobësimit nuk përdor energjinë e muskujve, por vetëm shkrin depozitat e yndyrës, në mënyrë që trupi të jetë i fortë dhe lëkura të mos varet gjatë humbjes së peshës. Këto kapsula merren nga dy me secilën qese";

- I gjithë shpjegimi i trajtimit me liposuksion ilustruhet vizualisht me sllajde promovuese - një lloj TV-fletushkash/fletëpalosje komerciale si për suplementet (Lipo- α dhe Lipo- β) ashtu edhe për "Qendrën Lipo-Diet". Sllajdet promovuese u transmetuan ose në monitor billboard elektronik si pjesë e skenografisë në studio, ose u shfaqën paralelisht, nga afër, përmes një ndarjeje montazhi të pamjes/xhirimit të kamerës së bisedës në studion televizive. Sllajdet promovuese u transmetuan vazhdimisht gjatë gjithë bisedës dhe ishin shkruar me mesazhe reklamuese të drejtpërdrejta që lidheshin me shëndetin e pacientëve potencialë dhe i referoheshin: - trashësisë së tepërt; - strii; - probleme me gjëndrën tiroide; - diabeti; dhe më shumë. Megjithatë, disa sllajde të caktuara promovuese, gjithashtu, përshkruajnë edhe figura të famshme nga jeta publike si përdorues të lipo-dietës së rekomanduar;

- Në fund të bisedës/emisionit, prezantuesi bën edhe një pyetje drejtuese: - (citat - pyetje) - " Në prag të Ditës së Gruas, 8 Mars, keni një surprizë shtesë për ata që duan. A nuk themi ne - merrni vendimin tani dhe menjëherë, dhe mos prisni për një ose dy ose tre muajt e ardhshëm? "

- (citat - përgjigje) – " Gjatë kësaj jave, deri më 8 mars, përfshirë edhe 8 marsin, të gjithë ata që blejnë të gjithë paketën e dietës me liposuksion do të marrin falas një peshore për matjen e peshës trupore. "

- Logoja për program me plasim të produkteve është vendosur vetëm 5 sekonda para fillimit të emisionit - nga ora 09:15:12 deri në 09:15:17; - Logoja, si kujtesë editoriale (për publikun) që duhet të dallojë qartë llojet e ndryshme të komunikimit komercial audiovizual dhe përmbajtjen e emisionit, nuk u vendos as pas pauzave për dy blloqet reklamuese (nga ora 09:17:46 deri në 09:20:23; nga ora 09:41:00 deri në 09:43:35 – në të cilat u transmetuan edhe spote reklamuese - si për "Qendrën Lipo-Diet" nga Shkupi ashtu edhe për metodën e "liposuksionit jo-invaziv" duke përdorur suplementet e lartpërmendura) dhe as në fund të emisionit.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1372/1 datë 27.03.2025, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip më 28.03.2025, dërgoi shkresë – Dorëzim i raport me shkrim nga mbikëqyrja për deklaram ark.nr.10-1372/2 datë 28.03.2025, me të cilin i dorëzoi Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1372/1 datë 27.03.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzojë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt më 01.04.2025. Në afatin e parashikuar, SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 24.04.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 55 paragrafi (2) nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të LSHMAAV dhe pikat 25 dhe 26 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr. 10-1372/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1832/4 datë 24.04.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën mbajtur më 24.04.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR 24 VESTI SHPKNJP Shtip dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve. Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, është marrë aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1372/1 datë 27.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.